




Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren
University "Ukshin Hoti" Prizren



KËSHILLI DREJTUES

Rruga e Shkronjave Nr.1, 20000 Prizren -Kosovë; Tel:+381 (0) 29- 232 140; Homepage: www.uni-prizren.com

Kryesues i Këshillit Drejtues
Prof. Asoc. Dr. Arif Murrja

Prizren, 16.07.2021

Mbështetur në dispozitat ligjore të nenit 17, paragrafit 1 të Statutit të Universitetit 'Ukshin Hoti' Prizren, sipas referencës nr. 04-V-621, datë 30 maj 2013 si dhe në zbatim të nenit 52 të Ligjit Nr. 05/L-31 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Këshilli Drejtues, duke vendosur në lidhje me shfuqizimin e rregullores sipas ref. 01-35 të datës 09.02.2021 si dhe gjitha vendimet mbi plotësimin dhe ndryshimin e kësaj rregullore, në mbledhjen e mbajtur me datë 16.07.2021, mori këtë:

V E N D I M

- I. **SHFUQIZOHET** rregullorja për kompensimin e komisioneve që themelohen në nivel të Universitetit me nr. ref. 01-35 të datës 09.02.2018, vendimet nr. ref. 01-108 të datës 06.04.2021 dhe nr. ref. 01-269 të datës 03.11.2020, si dhe të gjitha vendimet mbi plotësimin dhe ndryshimin e kësaj rregullore e cila është miratuar në Këshillin Drejtues të Universitetit "Ukshin Hoti".
- II. Pavlefshmëria absolute e rregullores dhe vendimeve të lartcekura, e shpallur përmes këtij vendimi, ka efekt juridik në kuptim të Ligjit nr. 05/L-31 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.
- III. **OBLIGOHEN** organet drejtuese të Universitetit "Ukshin Hoti" për zbatimin e këtij vendimi.
- IV. Ky vendimi hyn në fuqi menjëherë.

A r s y e t i m

Duke u mbështetur në dispozitat e lartshënuara si dhe raportin e aludimit për pasqyrat financiare të MASHTI-t (tabela 4, pika 4 – paga dhe mëditje) si dhe duke marr parasysh se procedura e nxjerrjes së rregullores për kompensimin e komisioneve që themelohen në nivel të Universitetit sipas ref. nr. 01-35 i datës 09.02.2018 dhe vendimet nr. ref. 01-108 të datës 06.04.2021 dhe nr. ref. 01-269 të datës 03.11.2020, si dhe të gjitha vendimet mbi plotësimin dhe ndryshimin e kësaj rregullore janë në kundërshtim me dispozitat ligjore të nenit 80 të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, e që në kuptim të alinesë 1.5, paragrafi 1 të nenit 52 të Ligjit Nr. 05/L-31 për Procedurën e Përgjithshme përbën rast për pavlefshmëri absolute të rregullores të lartcekur së bashku me vendimet mbi plotësimin dhe ndryshimin e saj nga Këshilli Drejtues i Universitetit "Ukshin Hoti".

Andaj, në zbatim të dispozitave të lartcekura, Këshilli Drejtues i Universitetit "Ukshin Hoti" vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi palët e pakënaqura mund të iniciojnë konflikt administrative në Gjykatën Themelore në Prishtinë – departamenti për Çështje Administrative në afat prej 15 ditësh nga momenti i pranimit të këtij vendimi.

Vendimi i dërgohet:

Këshillit Drejtues;
Menaxhmentit të Universitetit;
Sekretarit të Përgjithshëm;
Shërbimeve përkatëse të administratës dhe
Arkivit

Kryesues i Këshillit Drejtues

Prof. Asoc. Dr. Arif Murrja

